



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

**KËRKESË PËR SHPREHJE INTERESI PËR ANGAZHIMIN SI EKSPERTË PËR
KONTROLLIN E SIGURIMIT TË CILËSISË PRANË BORDIT TË MBIKËQYRJES
PUBLIKE**

Bordi i Mbikëqyrjes Publike në zbatim të nenit 4, pika 6 e ligjit Nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 786 datë 09.11.2016 “Për procedurat e përzgjedhjes dhe rastet e shkarkimit të anëtarëve si dhe rregullat e organizimit e të funksionimit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike”, njofton të gjithë të interesuarit të paraqesin kërkesën e tyre për angazhimin si ekspertë të jashtëm për kryerjen e kontrollit për sigurimin e cilësisë pranë BMP.

1. Eksperti i jashtëm për Kontrollin e Cilësisë duhet të përmbush kriteret si në vijim:
 - a. Të jetë shtetas shqiptar me banim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë;
 - b. Të ketë zotësi për të vepruar;
 - c. Të ketë përfunduar studimet universitare të ciklit të dytë ose të zotërojë diplomë universitare të ekuivalentuar me këtë nivel në profilet auditim, kontabilitet ose financë, si dhe të ketë jo më pak se 10 vite përvojë pune të përgjithshme në fushën e auditimit ligjor dhe të raportimit financiar, kombinuar me trajnime specifike për dhënien e sigurisë së cilësisë. Nëse trajnimet konsiderohen të pamjaftueshme ato duhet të kryhen përpara nisjes së Kontrollit të Cilësisë;
 - ç. Të mos ushtrojë profesionin e audituesit ligjor;
 - d. Të mos jenë të përfshirë në organet drejtuese ose të punësuar në organizata të tjera profesionale subjekt i mbikëqyrjes së BMP-së;
 - e. Të mos jenë marrë ndaj tij/saj masa disiplinore të largimit nga puna për shkak të një shkelje të rëndë disiplinore gjatë dy viteve të fundit, kur kjo dispozitë është e aplikueshme;
 - f. Të mos jetë i dënuar apo i ndjekur penalisht nga organet e drejtësisë;
 - g. Të zotërojë gjuhën Angleze në nivel të pranueshëm dhe të përshtatshëm për punën.

Personat e interesuar duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm deri në datën 04.03.2022 pranë Bordit të Mbikëqyrjes Publike:

- Letër motivimi;
- CV;
- Fotokopje të diplomës së nivelit “Master”;
- Referencë pune nga punëdhënësi i mëparshëm;
- Dëshmi (librezë pune/ vërtetim, certifikata ose evidenca të cilat provojnë njohuritë profesionale dhe teorike) lidhur me eksperiencën dhe trajnimet e kryera.

Duke ju falënderuar,

Bordi i Mbikëqyrjes Publike